



Praktika e zakonshme në Ballkanin Perëndimor është që kur blihen drurët për ngrohje ruhen jashtë. Në këto raste, druri duhet të ndahet dhe të vendoset me anën e ndarë të pjesës së poshtme, për të lejuar qarkullimin e ajrit, larg shtëpisë dhe të mbahet larg nga toka. Nëse ruani dru të freskët - duhet të shmangni ruajtjen e tij në bodrume apo garazhe.

Druri i zjarrit i ruajtur jashtë duhet të mbrohet nga dëbora dhe shiu, duke mbuluar pjesën e sipërme të pirgjeve - për të lejuar qarkullimin e ajrit. Druri i prerë, i cili nuk është i rreshtuar, ka një periudhë më të gjatë të tharjes për rreth 2 muaj më shumë në krahasim me drurin e vendosur në rreth - për të arritur përmbajtjen e njëjtë të lagështirës.

THARJA

60% e drurit të përdorur për ngrohje në Ballkani Perëndimor nuk thahet si duhet. Kur druri pritet, qelizat e tij përmbajnë më shumë se 50% ujë. Djegia e e drurëve të tillë të lagur ose “jeshil” harxhon ngrohje në bërjen e avullit prodhon lëndë të ndezshme, acidike që shumë shpejt shkatërrojnë sobën dhe oxhakun tuaj, rrisin nivelin e tymit në dhomë dhe emetimet e substancave të dëmshme në atmosferë.

Përdorimi i drurit të thatë mund të kursejë para dhe të mbrojë shëndetin duke ulur emetimet. Nëse druri është tharë siç duhet, do të thotë që lagështia është ulur nga 40% në 20% gjatë periudhës 6-12 muajsh të tharjes, familja do të përdorë deri në 20% më pak dru për të ngrohur të njëjtën sipërfaqe! Në praktikë, kjo do të thotë që një shtëpi që përdor 10 m³ të drurit të freskët dhe me lagështi mund të ngrohë të njëjtën zonë të shtëpisë me 8 m³ të drurit të thatë siç duhet.

HAPA TË THJESHTË PËR TË THARË DHE RUAJTUR SIÇ DUHET DRUTË

1. Prerja – Çajë drutë që të thahen më shpejt
2. Rreshtimi – Rreshtoji drutë me anën e ndarjes poshtë, për të lejuar qarkullimin e ajrit, larg nga shtëpia, duke i mbajtur lart nga toka
3. Mbulesa - Mbuloni majën e pirgut për ta mbrojtur atë nga shiu dhe për të lejuar qarkullimin e ajrit

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans



4. Ruajtja- Duhet 6 muaj për dru të butë (p.sh. pisha, bredh) ose 12 muaj për dru të fortë (p.sh. ahu, lisi) për tu tharë

HAPAT E THJESHT PËR THARJEN DHE RUAJTJEN E DRUVE

PRERJA

1



Cani drutë që të thahen më shpejte

RENDITJA

2



Renditini drutë me anën e çarë të kthyer nga poshtë, ashtu që ta bëjë të mundur qarkullimin e ajrit, ruajeni larg shtëpisë dhe lart tokës

MBULIMI

3



Mbuloni pjesën e lart të druve të renditura ashtu që të lejohet qarkullimi i ajrit

DEPONIMI

4



Para përdorimit pritni që të thahet druri: 6 muaj për dru të buta (p.sh. pisha, bredhi, mill ose 12 muaj për dru të forta, lisi, frashti, dushku)

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans



HAPA TË THJESHTË PËR TË THARË DHE PËR TË RUAJTUR DRURIN SIÇ DUHET

1. ÇARJA- Çajë drutë që të thahen më shpejt
2. RRESHTOJI- Rreshtojini drutë me anën e ndarë poshtë për të lejuar qarkullimin e ajrit, larg nga shtëpia dhe mbaji lart nga toka.
3. MBULONI- Mbulojini drutë e rreshtuar për t'i mbrojtur nga shiu dhe për të lejuar qarkullimin e ajrit
4. Ruaji- Prisni 6 muaj për drurët e butë (p.sh pisha ose bredhi) ose 12 muaj për drurët e fortë (p.sh ahu, lisi etj) për t'u tharë

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans

